



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

Nr. 2660 Prot

Shkodër, më 11 . 2 . 2020



SHOQATA E ARTIZANËVE
SHQIPTAR

Nr. _____ Prot

Shkodër, më _____

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

Sot me datë ___/___/2020 lidhet kjo marrëveshje bashkëpunimi mes palëve:

Bashkia Shkodër me seli ligjore në rrugën “13 Dhjetori”, Shkodër, përfaqësuar nga zj. Voltana Ademi në cilësinë e titullarit të institucionit,
dhe

Shoqata e Artizanëve dhe Zejtarëve të Shqipërisë, me seli në rrugën “Nënë Klelia Merloni” Shkodër, përfaqësuar nga z. Zef Gjini me nr. NIPT-i K77301191H, në cilësinë e kryetarit të shoqatës.

Duke qënë se Palët:



Vlerësojnë rëndësinë e promovimit dhe zhvillimit të artizanatit Shqiptar si një traditë kombëtare.

Marrin në konsideratë politikat zhvillimore të Bashkisë Shkodër në drejtim të mbështetjes dhe zhvillimit të biznesit të vogël dhe të mesëm nëpërmjet zgjedhjes së llojeve të ndryshme të shërbimeve dhe lehtësirave të tjera publike në dobi të bashkisë.

Njohin eksperiencën e Shoqatës së Artizanëve dhe Zejtarëve të Shqipërisë, e cila e përbërë nga profesionistë artizanë angazhohet në strategjitë dhe nismat për përmirësimin dhe përdorimin e burimeve lokale për zhvillimin e biznesit të vogël dhe të mesëm, për promovimin dhe zhvillimin e artizanatit dhe produkteve territoriale.

Synojnë rritjen e vlerës së territorit të Bashkisë Shkodër duke mbrojtur, zhvilluar dhe promovuar vlerat e trashëgimisë kulturore me interes vendor.

Konfirmojnë angazhimin institucional për të bashkëpunuar në vijim të organizimit të aktiviteteve kulturore dhe promovimit të identitetit kombëtar lokal.



Palët së bashku bien dakord të nënshkruajnë këtë Marrëveshje Bashkëpunimi (këtu e më poshtë referuar si “**Marrëveshja**”), si më poshtë vijon:

Neni 1 **Baza ligjore**

- 1.1 Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar;
- 1.2 Ligji nr. 9632/2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar;
- 1.3 Ligji nr. 93/2015 “Për Turizmin, i ndryshuar;
- 1.4 VKB nr.1, datë 22.1.2016 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Shkodër, i ndryshuar.

Neni 2 **Objekti**

Bashkëpunim me qëllim zhvillimin e biznesit vendor në kuadër të promovimit dhe zhvillimit të artizanatit dhe produkteve territoriale sipas kalendarit vjetor të miratuar.

Neni 3 **Qëllimi i marrëveshjes**

Mbështetja në organizimin e panairove, ekspozitave dhe aktiviteteve promovuese sipas kalendarit të miratuar për vitin 2020, të Shoqatës së Artizanëve dhe Zejtarëve të Shqipërisë.


Neni 4 **Afati i marrëveshjes**

Kjo marrëveshje bashkëpunimi lidhet nga palët me vullnetin e tyre të lirë e të plotë, me afat nga momenti i nënshkrimit të saj deri me datë 31.12.2020.

Neni 5 **Forma e bashkëpunimit**

Bashkia Shkodër merr përsipër:

- a) Të vendos në dispozicion të Shoqatës së Artizanëve dhe Zejtarëve të Shqipërisë sheshin për zhvillimin e aktivitetit, sipas kalendarit vjetor bashkëlidhur kësaj marrëveshje.
- b) Të përjashtojë nga tarifa e përkohshme Shoqatën e Artizanëve dhe Zejtarëve të Shqipërisë për aktivitet e organizuar apo në partneritet me Bashkinë Shkodër për promovimin e produktit territorial.
- c) Të koordinojë pjesmarrjen e Shoqatës së Artizanëve dhe Zejtarëve të Shqipërisë në panairot që organizohen nga Bashkia Shkodër për promovimin e artizanatit.
- d) Të vlerësojë efektshmërinë e panairove të organizuara.
- e) Të respektojë nen për nen marrëveshjen.



Adresa: Rr. "3 Dhjetori", Nr.1, Shkodër, web: www.bashkiashkoder.gov.al, e-mail: info@bashkiashkoder.gov.al

SHOQATA E
ARTIZANEVE DHE
ZEJTAREVE TE SHQIPERISE

Shoqata e Artizanëve dhe Zejtarëve të Shqipërisë merr përsipër:

- a) Të organizojë panairët në respektim të kalendarit vjetor, bashkëlidhur kësaj marrëveshje.
- b) Të respektojë kalendarit vjetor të panaiereve, miratuar nga Bashkinë Shkodër.
- c) Të mirëmbajë sheshin e rregullt dhe në fund të dorëzojë sheshin në të njëjtën gjëndje që është marrë në dorëzim, në të kundërt do të penalizohet sipas dispozitave ligjore.
- d) Për panairët e organizuara nga shoqata në kuadër të kësaj marrëveshje, pjesëmarrja e artizanëve në këto panaiere duhet të jetë pa pagesë ndaj çdo pale të tretë.
- e) Të njoftojë Bashkinë Shkodër në rast zhvillimi të aktiviteteve promovionale si dhe për çdo aktivitetet shtesë.
- f) Të njoftojë Bashkinë Shkodër për çdo vështirësi të identifikuar gjatë zbatimit të marrëveshjes.
- g) Të respektojë nen për nen marrëveshjen.

Neni 6 Komunikimi

Çdo komunikim midis palëve do të bëhet me shkrim.

Neni 7 Njoftimet

- 7.1 Çdo njoftim, kërkesë apo çdo lloj komunikimi mes palëve do të bëhet sipas mënyrës së parashikuar në këtë marrëveshje bashkëpunimi.
- 7.2 Njoftimi i palëve do të bëhet me shkrim brenda 15 ditëve nga marrja dijeni e faktit dhe problemeve që mund të lindin gjatë ekzekutimit të marrëveshjes.

Neni 8 Zgjidhja e marrëveshjes

- 8.1 Asnjëra nga palët nuk ka të drejtë të zgjidhë këtë marrëveshje në mënyrë të njëanshme pa shkaqe të arsyeshme dhe para se të kenë njoftuar me shkrim njëra-tjetrën të paktën 30 ditë përpara.
- 8.2 Palët bien dakort që çdo mosmarrëveshje apo kontradite do të përpiqen t'i zgjidhin me mirëkuptim.
- 8.3 Nëse palët dështojnë në zgjidhjen e mosmarrëveshje ose konfliktit, ato i drejtohen zgjidhjes së marrëveshjes dhe procedurave juridike në fuqi, sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë.

Neni 9 Dispozitat e fundit

9.1 Pjesë përbërëse dhe e pandarë e kësaj marrëveshje është kalendari vjetor i panaiereve bashkëlidhur kësaj marrëveshje.



9.2 Kjo marrëveshje bashkëpunimi do të quhet e vlefshme duke filluar nga data e nënshkrimit të saj nga palët.

9.3 Kjo marrëveshje u hartuar në tre kopje, nga të cilat njëren e merr shoqata ndërsa dy Bashkia Shkodër.

PËR
BASHKINË SHKODËR



PËR
SHOQATËN E ARTIZANËVE DHE
ZEJTARËVE TË SHQIPËRIË

KRYETAR

Zef Gjini



ANEKSI I

Kalendari i panaireve të planifikuara për vitin 2020.

Nr.	Muaji	Datat	Evenimentet	Vendi
1	Shkurt	14 - 15	Dita e Shën Valentinit	Pedonale "Kolë Idromeno" Shkodër
2	Mars	7 - 8	Festa e mësuesit dhe gruas	Pedonale "Kolë Idromeno" Shkodër
3	Mars	14 - 15	Dita e Verës	Pedonale "Kolë Idromeno" Shkodër
4	Prill	10 - 11	Festa e Pashkëve	Pedonale "Kolë Idromeno" Shkodër
5	Maj	6	Festa e Luleve	Pedonale "Kolë Idromeno" Shkodër
6	Maj	22 - 23	Festa e Bajramit	Pedonale "Kolë Idromeno" Shkodër
7	Qershor	10 - 12	Dita e Artizanatit	Pedonale "Kolë Idromeno" Shkodër
8	Qershor	19 - 20	Dita e Liqenit	Pedonale "Kolë Idromeno" Shkodër
9	Korrik	4-5, 11-12, 18-19, 25-26	Panair Veror	Velipojë
10	Korrik	30 - 31	Festa e Bajramit	Pedonale "Kolë Idromeno" Shkodër
11	Gusht	1-2, 8-9, 15-16, 22-23	Panair Veror	Velipojë
12	Gusht	29 - 30	Panair Veror për Emigrantët	Pedonale "Kolë Idromeno" Shkodër
13	Shtator	26 - 27		Pedonale "Kolë Idromeno" Shkodër
14	Tetor	24 - 25		Pedonale "Kolë Idromeno" Shkodër
15	Nëntor	28 - 29	Festa e Nëntorit	Pedonale "Kolë Idromeno" Shkodër
16	Dhjetor	3 - 5	Festa e Shënkollit	Pedonale "Kolë Idromeno" Shkodër
17	Dhjetor	18 - 31	Festa e Fundvitit	Pedonale "Kolë Idromeno" Shkodër

SHOQATA E
ARTIZANEVE
SHKODËRE